



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

---

**URDHËR**

**Nr. 107, date 18.05.2010**

**“Mbi procesin e trajnimit të prokurorëve”**

*Me synimin*, për të siguruar rritjen e vazhdueshme të profesionalizmit të prokurorëve, për të garantuar zbatimin e ligjit nga të gjithë prokurorët sipas të njëjtave standarte, dhe për të rritur efikasitetin e drejtimit unik dhe të centralizuar të Prokurorisë.

*Në mbështetje*, të nenit 8 pika 2 germa “gj” e vijues të ligjit Nr. 8737 datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë ":

**URDHËROJ**

**Neni 1**

**Parimet e procesit të trajnimit të prokurorëve**

1. **Drejtimi i procesit të trajnimit** – Procesi i trajnimit të prokurorëve drejtohet nga Prokurori i Përgjithshëm, me pjesëmarrjen aktive të Bordit të Organizimit të Trajnimit (BOT)
2. **Uniformiteti i trajnimit.** Procesi i trajnimit të prokurorëve duhet të sigurojë shpërndarjen e njohurive profesionale në mënyrë të tillë që të sigurohet i njëjti kuptim mbi dispozitat e ligjit dhe të Urdhrave/Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
3. **Gjithpërfshirja e trajnimit.** Procesi i trajnimit duhet të sigurojë shpërndarje të balancuar të njohurive tek të gjithë prokurorët pavarësisht nga diferencat e kushtëzuara nga specializimi në punën e tyre.
4. **Specializimi i trajnimit.** Procesi i trajnimit duhet të sigurojë një trajnim të orientuar sipas nevojave konkrete që kanë prokurorët, bazuar në kritere të tilla si veprat penale që ata ndjekin, fazës së procedimit penal ku ata marrin pjesë

(hetim/gjykim/ekzekutimim vendimesh penale) apo vendit që zënë në hierarkinë vendimmarrëse (drejtues në Rreth, Apel, Prokurori të Përgjithshme)

5. **Shumanshmëria e trajnimit** – Procesi i trajnimit duhet të sigurojë që krahas njohurive ngushtësisht profesionale, prokurorët të marrin edhe njohuri të lidhura në mënyrë indirekte me profesionin e prokurorit, apo çdo njohuri tjetër të karakterit teknik apo instrumental që rezulton i nevojshëm për ushtrimin e funksionit të prokurorit.

6. **Pjesmarrja në planifikimin e trajnimit** – Procesi i trajnimit duhet të sigurojë që hartimi i planeve të trajnimit të bëhet, përmes BOT, me pjesmarrjen e gjerë të prokurorëve të të gjitha shkallëve.

7. **Transparenca e procesit të trajnimit** – Procesi i trajnimit duhet të zhvillohet në përputhje me parimet e transparencës dhe publicitetit.

8. **Kontrolli i njohurive të perfituara** – Procesi i trajnimit duhet të sigurojë kontrollin dhe vlerësimin periodik të njohurive.

## Neni 2

### Bordi për Organizimin e Trajnimit (BOT)

Bordi për Organizimin e Trajnimit (BOT), është një organ keshillimor i Prokurorit të Përgjithshëm dhe me kompetenca vendimmarrëse në mbarë vendin në drejtimin dhe organizimin e procesit të trajnimit të prokurorëve, kompetenca të cilat përcaktohen në këtë Urdhër.

## Neni 3

### Drejtimi dhe përbërja BOT

1. BOT përbëhet nga :

- Drejtori i Drejtorisë së Inspektimit të Prokurorisë së Përgjithshme
- Një prokuror nga Drejtoria Gjyqësore
- Një prokuror nga Drejtoria e Kontrollit të Hetimit
- Një anëtar i Drejtorisë së Studimeve
- Një anëtar i Drejtorisë së Marrdhënieve me Jashtë
- Një prokuror, përfaqësues i Prokurorive të Apeleve
- Një prokuror, përfaqësues i Prokurorive të Rretheve
- Një prokuror, përfaqësues i Prokurorisë së Krimeve të Rënda
- Një anëtar i Keshillit Prokurorisë
- Një anëtar i Shoqatës së Prokurorëve

2. BOT drejtohet nga Drejtori i Inspektimit në Prokurorinë e Përgjithshme i cili përfaqëson BOT dhe Institucionin e Prokurorisë në çështjet që lidhen me trajnimin e prokurorëve. Mbledhja e BOT zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 6 nga anëtarët e tij.

## **Neni 4**

### **Emërimi i anetarëve të BOT**

1. Prokurori i Përgjithshëm, nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit njofton të gjithë prokurorët dhe personat e tjerë të interesuar të aplikojnë për t'u bërë anëtarë të BOT. Afati për bërjen e aplikimeve është një muaj nga dita e njoftimit.
2. Pas përfundimit të procesit aplikimit, i cili organizohet nga drejtuesi I BOT, Prokurori i Përgjithshëm përzgjedh kandidaturat në përputhje me kriteret e parashikuara në nenet 3 dhe 5 të këtij urdhëri. Nëse për një nga pozicionet në BOT nuk ka asnjë aplikim, emri përzgjidhet nga Prokurori i Përgjithshëm.

## **Neni 5**

### **Përzgjedhja e kandidaturave për anëtar të BOT**

1. Të drejtën për të qenë anëtar i BOT e kanë të gjithë personat ndaj të cilëve nuk ka një masë disiplinore në fuqi dhe plotësojnë një nga këto kriteret:
  - a- Kanë ushtruar detyrën si prokuror jo më pak se 7 vjet dhe nuk e kanë ndërprerë aktivitetin e prokurorit të paktën 5 vitet e fundit
  - b- Janë aktivizuar në mësimdhënie
  - c- Kanë qenë oponent/drejtes temash diplome të studentëve të Fakultetit Juridik apo të Shkollës së Magjistraturës
  - d- Kanë kryer studime pasuniversitare.
2. Drejtuesi i BOT i paraqet Prokurorit të Përgjithshëm propozimin për emërimin si anëtar i BOT, jo më vonë se 1 muaj nga përfundimi i të gjithë zgjedhjeve për kandidatë në çdo strukturë të Prokurorisë.

## **Neni 6**

### **Mbarimi i detyrës së anëtarit të BOT**

1. Detyra e anëtarit të BOT si rregull zgjat për një periudhë 3 vjecare.
2. Detyra e anëtarit të BOT mbaron para afatit 3 vjecar me Urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm nëse:
  - a. anëtari largohet nga struktura përkatëse e Prokurorisë e cila e ka propozuar për anëtar të BOT.
  - b. anëtari nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga ky Urdhër.
  - c. ndaj anëtarit jepet një masë disiplinore
3. Drejtuesi i BOT njofton Prokurorinë e Përgjithshëm sapo konstaton njërin nga rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni dhe i propozon nisjen e procedurave për

zëvendësimin e tij. Prokurori i Përgjithshëm nëse vlerëson se janë kushtet për mbarimin e detyrës së anëtarit të BOT, shpall vëndin vakant dhe njofton nisjen e aplikimeve sipas nenit 4.

4. Detyra e anëtarit të BOT ruhet edhe pas përfundimit të afatit 3 vjeçar nëse :
  - a. Prokurori i Përgjithshëm nuk nxjerr Urdhërin përkatës për mbarimin e detyrës si anëtar I BOT.

## **Neni 7**

### **Emërimi dhe shkarkimi i prokurorëve si ekspert – trajnues**

1. Çdo vit, BOT, pasi evidenton nevojat për trajnim dhe fushat përkatëse ku do kryhet trajnimi, njofton të gjithë prokurorët e interesuar që të aplikojnë për të qenë ekspert trajnues në listën e temave të përzgjedhura nga ai.
2. Në bazë të kërkesave BOT përzgjedh jo më pak se katër kandidatë për secilën temë dhe ja propozon listën e kandidatëve dhe temat përkatëse për miratim Prokurorit të Përgjithshëm. Kandidatët duhet të plotësojnë të njëjtat kritere që ka vendosur edhe Shkolla e Magjistraturës. Për çdo temë caktohen dy prokurorë.
3. Pas përzgjedhjes dhe miratimit të listës nga Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i BOT ia sugjeron këtë listë Shkollës së Magjistraturës për ta marrë parasysh në planifikimin e programeve të trajnimit vazhdues.
4. Për temat të cilat nuk bëhet e mundur të futen në PTV të Shkollës së Magjistraturës apo edhe në raste të tjera kur vlerësohet e nevojshme, BOT organizon vetë zhvillimin e trajnimeve sipas temave dhe ekspertëve të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Në këto raste është vetë BOT që do të miratojë materialin e përgatitur nga ekspertët trajnues, të cilët kanë detyrimin t’ja dërgojnë jo më pak se dy javë përpara zhvillimit të trajnimit BOT.
5. Zëvendësimi i ekspertit trajnues bëhet kur materiali i përgatitur nuk është në nivelin e duhur apo për pamundësi objektive të ekspertit për të zhvilluar trajnimin. Për zëvendësimin e ekspertit BOT i propozon Prokurorit të Përgjithshëm një nga emrat që kanë aplikuar dhe nëse nuk ka pasur aplikime apo aplikuesit nuk përmbushin kriteret për të qenë ekspert, është Prokurori i Përgjithshëm që nëse e vlerëson të domosdoshëm zhvillimin e trajnimit cakton një prokuror si ekspert për trajnimin

## **Neni 8**

### **Kopetencat e BOT**

1. BOT identifikon nevojat për trajnim dhe organizon përzgjedhjen e ekspertëve në përputhje me nenin 7 të këtij urdhëri.
2. Miraton listën e propozuar të nga drejtuesi i BOT të prokurorëve që do të marrin pjesë në trajnimet që do të organizohen nga BOT.

3. Organizon punën për kontrollin e pjesëmarrjes së prokurorëve në trajnime, kërkon nga Shkolla e Magjistraturës vlerësimet e bëra për ekspertët trajnues të propozuar nga BOT si dhe merr masa për vlerësimin e ekspertëve trajnues në trajnimet e organizuara nga BOT

4. I propozon Prokurorit të Përgjithshëm numrin minimal dhe maksimal të rajnimeve në kuadër të PTV, gjatë një periudhe kohe të caktuar.

## **Neni 9**

### **Detyrat e drejtuesit të BOT**

Drejtuesi i BOT ka këto detyra :

1. Organizon mbledhjen e BOT, me iniciative ose me Urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe drejton punimet e saj.
2. Përcakton, me iniciative ose me Urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, përmbajtjen e axhendës së mbledhjes së BOT
3. Përgatit propozimet e mbledhjes së BOT dhe i'a paraqet ato për miratim Prokurorit të Përgjithshëm.
4. Luan rolin e koordinatorit të Prokurorisë me Shkollën e Magjistraturës.
5. Për përmbushjen e veprimtarisë së tij kryen çdo veprimtari tjetër me qëllime organizative, e cila nuk bie ndesh me rregullimet e këtij urdhëri.
6. Çdo vit drejtuesi i BOT i paraqet Prokurorit të Përgjithshëm një raport mbi veprimtarinë e zhvilluar. Ky raport miratohet paraprakisht nga BOT.

## **Neni 10**

### **Procedura e përcaktimit të temave objekt trajnimi të PTV**

1. BOT përcakton temat objekt trajnimi që do të sygjerohen Shkollës së Magjistraturës, duke u bazuar në Raportin e secilit anëtar të BOT në të cilin në mënyrë të përmbledhur dhe sipas perkatësisë në strukturën përkatëse që anëtari përfaqëson duhet të pasqyrohen:

- a. Shkeljet më të shpeshta të ligjit penal dhe procedural penal dhe të Urdhrave/Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
- b. Praktikrat e paqarta në zbatimin e ligjit penal dhe procedural penal dhe Urdhrave/Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
- c. Veprat penale me tendence rritjeje si dhe ato për të cilat Gjykatat kanë vendosur ndryshimin e cilësimit të veprës penale, pushimin e çështjeve për mungesë provash, ose mospranimin e ankimit të prokurorëve.
- d. Rastet e ndryshimeve në legjislacion si dhe në Urdhrat/Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Çdo Prokurori Rrethi si dhe çdo Prokurori Apeli detyrohet t'i japë anëtarit përfaqësues të tyre në BOT ridiksionit të Apelit, informacionin e nevojshëm të kërkuar prej tij për plotësimin e Raportit në drejtim të pikave të mësipërme.

## **Neni 11**

### **Detyrat e prokurorit ekspert-trajnes**

Prokurori - ekspert trajnimi ne PTV ka këto detyra:

1. Të përgatis me shkrim materialet përkatëse që lidhen me temën objekt trajnimi duke treguar kujdesin maksimal për të mos rënë ndesh me frymën e Urdhrave/Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, Vendimeve të Kolegjeve të Bashkuara dhe të Gjykatës Kushtetuese.
2. Të dorëzojë materialin trajnes të përgatitur në kuadër të PTV, pranë drejtuesit të BOT jo më vonë se një muaj pas datës së zhvillimit të trajnimit. Në rastet e trajnimeve të organizuara nga BOT materiali duhet të dorëzohet të paktën 2 javë përpara datës së caktuar për trajnimin. Materialet e dorëzuara drejtuesi i BOT ia kalon Drejtorisë së Studimeve dhe Biblotekës së Prokurorisë.
3. Të njoftojë me shkrim sa më parë, sipas rastit, drejtuesin e BOT për pamundësinë objektive të pjesmarrjes sipas planifikimit në sesionin trajnes të organizuar nga BOT.
4. Të japë çdo shpjegim të nevojshëm për pjesmarrësit në trajnim dhe me kërkesen e tyre t'u dorëzojë një kopje të materialit të trajnimit.
5. Të paraqesë me shkrim, pas përfundimit të trajnimit, pranë Drejtuesit të BOT një raport lidhur me shqetësimet e shfaqura në praktikë që lidhen me temën objekt trajnimi.

## **Neni 12**

### **Detyrat e prokurorit të trajnuar**

Prokurori i trajnuar ka këto detyra :

1. Planifikon punën për të mos munguar në sesionet e planifikuara trajnuese të PTV.
2. Njofton me shkrim sa më parë drejtuesin e BOT për pamundësinë objektive të pjesmarrjes në sesionin trajnes të PTV.

## **Neni 13**

### **Vlefshmeria e akteve të BOT**

Te gjitha vendimet dhe aktet e nxjerra nga BOT dhe drejtuesi i BOT, kur konstatohen se janë marrë në kundërshtim me këtë Urdhër, janë subjekt i shfuqizimit nga Prokurori i Përgjithshëm.

## **Neni 14**

Ky Urdhër hyn në menjëherë

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

---

**Ina RAMA**